



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 57, datë 12.03.2021

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORIT KRESHNIK AJAZI, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të prokurorit Kreshnik Ajazi, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit Kreshnik Ajazi, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Kreshnik Ajazi të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Kreshnik Ajazi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.


**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**


**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**




**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTAR  
VATË STAKAJ**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR  
MOISI DUDA**